



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22 Shkurt 2021

Nr: 95

VENDIM

**PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË SË PUNËS SË SHQIPËRISË PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS
25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 64 dhe 92/2 pika 2 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia e Punës e Shqipërisë, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Partia e Punës e Shqipërisë, me shkronja nistore “P.P.Sh”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z. Bardhyl Hazizaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021, administruar me nr. 2127 prot., datë 27.11.2020 dhe nr. 247 prot., datë 11.01.2021.

Kërkesa e paraqitur nga Partia e Punës e Shqipërisë, respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga Partia e Punës e Shqipërisë, për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, përbëhet si më poshtë:



Data: 22 Shkurt 2021

Nr. 95

Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë së Punës së Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021

- a) Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30.09.2020, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia e Punës e Shqipërisë, me iniciais “P.P.Sh”, me Kryetar z. Bardhyl Hazizaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- d) specimeni i vulës së partisë;
- dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (zj. Flutura Meta);
- e) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (z. Bardhyl Hazizaj);
- ë) deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet;

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia e Punës e Shqipërisë, janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 92/2 pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon hapjen e llogarisë së posaçme në banka nga subjekti zgjedhor si dhe duhet të deklarohet në momentin e regjistrimit të partive politike sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

Referuar dispozitës së sipërcituar, Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka depozituar numrin e llogarisë së posaçme sipas deklaratës Model 01/1 të miratuar me udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 660 prot., 28.01.2021, i ka kërkuar kryetarit të partisë z. Bardhyl Hazizaj, hapjen e numrit të llogarisë së posaçme sipas Modelit 1/1 të miratuar me udhëzimin nr.01, datë 23.12.2020, brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit. Rezulton se z. Hazizaj, ka marrë dijeni në datën 29.01.2021.



Brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 64 pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përkatësisht data 15.02.2021, z. Bardhyl Hazizaj, nuk ka depozituar plotësimin e dokumentacionit, për regjistrimin e Partia e Punës e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n” e 2, 64 dhe 92/2 pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të mos regjistroj si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, Partia e Punës e Shqipërisë, me Kryetar z. Bardhyl Hazizaj, me shkronjat nistore “P.P.S.h”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

